



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

---

Numri i lëndës: 2019:226945

Datë: 20.06.2024

Numri i dokumentit: 05842505

**C.nr.642/2018**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**, si gjykatë civile e shkallës së parë, me gjyqtarin Blerim Istrefi dhe me bashkëpunëtoren profesionale F.A-XH, në çështjen juridike kontestimore të paditësit M.P.M.S -D... i Administratës Pensionale te Kosovës, kundër të paditurit S.T me adresë në fshatin S.... K-Mitrovicë, lidhur me çështjen juridike: pasurimi i pa bazë, vlera e kontestit 315.00 euro, jashtë seancës gjyqësore, me datë 20.06.2024, nxjerr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Për shkak të pa dëgjueshmërisë / mosbindjes**

**I.APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadija e paditësit D... i Administratës Pensionale të Kosovës, ashtu që **OBLIGOHET** i padituri S.T nga Mitrovica, që paditëses, në emër të pasurimit të pa bazë ti kthej shumën e përgjithshme të detyrimit prej 315.00 euro, në afte prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nen kërcënimin të përmbarimit të dhunshëm, e cila pages duhet të deponohet në llogarinë rrjedhëse të paditëses M.P.M.S -D... i Administratës Pensionale te Kosovës nr.....

**II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Paditësja, në këtë gjykatë ka paraqitur padi me datë 17.09.2018, kundër të paditurit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i paditurin, që paditëses në emër të pasurimit të pabazë ti kthej shumën e përgjithshme të detyrimit prej 315.00 euro, shumë të cilin i padituri e ka fituar pa bazë juridike pasi që i njëjti pas vdekjes se përfitueses së pensionit Miradije Tahiri, e ka tërhequr shumën prej 315.00 euro nga baza e pensionit sipas autorizimit që kishte i njëjti nga e ndjera.

Gjykata, me aktvendimin C.nr.642/2018 te datës 11.10.2022, e ka detyruar të paditurin që të përgjigjet në padi, nën paralajmërimin që nëse nuk parqet përgjigje në padi në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit te aktvendimit të lartpërmendur, gjykata do të merr aktgjykim në bazë të padëgjueshmërisë/mosbindjes.

I padituri, aktvendimin C.nr.642/2018 te datës 11.10.2022 e ka pranuar me datën 12.10.2022 ky fakte vërtetohet nga flet kthesa e datës se lartcekur mirëpo i njëjti nuk është përgjigjur në padi, andaj gjykata ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për të marr aktgjykim, për shkak të padëgjueshmërisë/mosbindjes, bazuar në dispozitat ligjore te nenit 150 paragrafi 1 pikat a, b dhe c, të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK).

Paditësja me provat e bashkangjitura i ka bërë të besueshme faktet e padisë, dhe themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi dhe atë nga vendimi i lëshuar nga Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes vërtetohet fakti se M.J tashmë e ndjera i është njohur e drejta në pension që nga data 02.12.2006 në shumën prej 40.00 euro për çdo muaj, nga autorizimi i datës 09.03.2007 vërtetohet fakti se i padituri ka qenë i autorizuar nga e ndjera për tërheqjen e pensionit nga banka , kurse nga qarkullimi për llogari e lëshuar nga N.... Bankë e datës 04.04.2018 vërtetohet fakti se i padituri ka tërhequr shumën prej 315.00 euro

Gjykata, duke vërtetuar në mënyrë të padyshimtë gjendjen faktike me prova material dhe duke u bazuar në nenin 194 të LMD-së, në të cilën parashihet që " secili person që pasurohet pa baze ligjore në dëm të një tjetrit, është i detyruar që ti kthej atë që ka marrë nga tjetri... "andaj në mbështetje të dispozitës së lartcekur gjykata ka obliguar të paditurin, që paditëses ti kthej shumën prej 315.00 euro, pasi që i njëjti nuk ka pasur të drejt të tërheq shumën e kërkuar në emër të pensionit që i ka takuar tashmë të ndjerës Miradije Tahiri, pas vdekjes së sajë.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale është marrë konform dispozitës së nenit 450 të LPK-së.

Nga arsyet e theksuara më lartë, në bazë të nenit 150 paragrafi 1 pikat a, b dhe c, të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK)-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**D... i Përgjithshëm-Divizioni Civil**  
**C.nr.642/2018, datë 20.06.2024**

**Gjyqtar**  
Blerim Istrefi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate.